



Asociacioni i Komunave të Kosovës

**RAPORTI
NARRATIV
I PROGRESIT
2018**

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Aktivitetet e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) gjatë vitit 2018 ishin të bazuara në Planin Strategjik të AKK-së për vitin 2016-2020, Planin Vjetor 2018 si dhe në agjendën legislative e prioritetet vjetore të përcaktuara nga strukturat udhëheqëse.

Qëllimi i përgjithshëm vazhdon të jetë i njëjtë, të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e komunave anëtare duke ofruar shërbime për të përmirësuar performancën e tyre, nëpërmjet konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të AKK-së dhe duke siguruar performancë të mirë financiare.

AKK-ja, përveç ligjeve dhe akteve të shumta nën/ligjore, si prioritet këtë vit lloboi në projektligjet:

1. Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
2. Projektligji për Zyrarët Publik;
3. Projektligji për Pagat;
4. Projektligji për Miniera dhe Minerale.
5. Koncept Dokumenti në ligjit të Financave të Pushtetit Lokal

AKK ka kaluar fazën tranzitore të konstituimit të organeve të saja pas asnjë problem në fillim vitin 2018. Ndryshimet politike nëpër komunat e Kosovës ndikojnë edhe në ndryshimin e përfaqësimit të kryetarëve në Bordin e AKK-së. Edhe pse këto ndryshime kanë ndodhur, puna e AKK-së ka vazhduar pa asnjë problem. Kjo tregon për pjekurinë insitucionale e cila është zhvilluar ndër vite në Kosovë. Pra, bazuar në mentalitetin ballkanik, zakonisht ndryshimet politike mund të përcillen edhe me probleme insitucionale dhe organizative, mirëpo kjo në AKK nuk ka ndodhur.

Lobimi dhe Avokimi: Çështjet e suksesshme të vitit 2018

Gjatë vitit 2018 AKK-ja ka marrë pjesë në një numër të madh takimesh të grupeve punuese të ndryshme qeveritare dhe komisioneve parlamentare me qëllim të dhënies e vërejtjeve dhe sugjerimeve si dhe shqyrtimin e projektligjeve gjatë shqyrtimit të legjislacionit.

Në mes numrit të madh të aktiviteteve lobuese dhe avokuese gjatë vitit 2018, shumë prej tyre në baza ad-hoc/urgjente të detajuara në këtë raport, 8 rastet e mëposhtme të suksesshme të lobimit meritojnë vëmendje të veçantë pasi që ato ndikojnë drejtpërdrejt në çështjet financiare dhe menaxhuese të komunave.

1.1. Peticioni si formë e re presioni në lobim

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar peticionin për rregullimin meritor të çështjes së të ardhurave të Anëtarëve të Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe pjesës tjetër komunale. Ky peticion është përkrahur nga të gjithë kryetarët, drejtorët, anëtarët e KK-ve pa marrë parasysh përkatësinë politike dhe etnike. Menjëherë pas organizimit të peticionit, institucionet qendrore kanë reaguar duke avancuar në prioritet çështjen e rregullimit të kësaj teme me projektligjin e pagave që ishte në procedurë e sipër. Organizimi i peticionit dhe presioni përmes tij është formë e re e avokimit të çështjeve komunale, e i cili dha rezultatin e vetë. Reagimi i shpejtë nga ana e institucioneve qendrore

tregon sa për fuqinë që ka organizimi unik i pushtetit lokal përmes AKK-së aq edhe për arsyeshmërinë e këtyre kërkesave nga ana e komunave.

1.2. Përsëri ndalohet Akademia për Vetëqeverisje Lokale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka mirëkuptuar dhe pranuar kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) për të mos themeluar Akademinë për Vetëqeverisje Lokale, që ishte paraparë në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe si objektivi i inkorporuar në Planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin 2017.

Pas përpjekjeve të reja (2017 - hera e parë dhe 2018 - hera e dytë), AKK ka reaguar ndaj një iniciative të tillë si e pa nevojshme dhe si dyfishim i punës së institucioneve ekzistuese relevante për këtë fushë, siç është Instituti Kosovar i Administratës Publike dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, të cilat me ligj janë të parapara si institucione të cilat ofrojnë shërbime për ngritjen të kapaciteteve në nivelin komunal. Ky reagim argumentues i AKK-së ka hasur në mirëkuptim të institucioneve përkatëse dhe të donatorëve dhe formimi i kësaj Akademie është ndaluar. Poashtu në formën e propozuar kishte tendenca për zbehjen e rolit të AKK-së në fushën e ngritjes së kapaciteteve për komunat e Kosovës.

1.3. Miliona euro më shumë për komunat nga lobimi i AKK-së

Përfaqësuesit e AKK-së anëtar të Komisionit të Granteve në Ministrinë e Financave, në takimin ku është shqyrtuar edhe Korrniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), janë ngritur disa problematika të cilat do të duhej të rregullohen me anë të buxhetit.

- Për dallim nga viti 2018 buxheti për komunat e Kosovës për vitin 2019 do të jetë 517,57 milion euro, pra për 35 milion euro më shumë ose për 8% më i lartë,
- Dallimi në mes të vitit 2018 dhe vitit 2019 është që komunat do të kenë 5% më shumë buxhet ose 7,1 milion euro në grantin e përgjithshëm,
- Granti Specifik për Arsim parashihet të jetë për 10% më i lartë në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ose për 17,1 milion euro më shumë,
- Granti Specifik për Shëndetësi parashihet të jetë për 10% më i lartë në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ose për 5 milion euro më i lartë,
- Projektionet për të hyra vetanake në komuna për vitin 2019 do të jenë 5 milion euro (6%) më të larta në krahasim me vitin 2018.

1.4. Renta minerare 20 %, do të ju ndahet komunave ku operojnë bizneset

Bazuar në praktikat e rajonit, AKK-ja kërkoj që 20% e rentës së mbledhur minerare të alokohet në buxhetin e komunës ku operohet. Pra ato komuna në të cilat operonin bizneset për minera dhe minerale të përfitojnë këtë përqindje meqenëse në teritorin e asaj komune shkaktoheshin punime në tokë, kishte edhe pengesa për banorët dhe ndotej ambienti i asaj zone. Në dëmshpërblim të këtyre dëmeve të iu kthehej komunave një investim që do të përfitonin banorët në disa fusha kryesore, si në shëndetësi, arsim, mjedis, kulturë e sport. Shifra që Komunat që do të përfitojnë nga kjo rentë minerare kap shumën

deri në 12 milion euro në vit. Amendamentet e propozuara nga AKK, janë miratuar në Kuvend të Kosovës pritet edhe shqyrtimi i propozimeve tjera dhe miratimi i projektligjit në tërësi.

1.5. Projektligji për Ndërmarrjet Publike

Lobimi rreth Projekt Ligjit për Ndërmarrjet Publike, (duke qenë anëtar i Grupit Punues) ka vazhduar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, si përgjegjëse për hartimin e këtij projektligji, ka konsideruar rolin e AKK-së si përfaqësues unik i komunave duke kërkuar që dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me komunat, të hartohen dhe formulohen ekskluzivisht nga AKK, proces i cili është kompletuar përmes strukturave përkatëse profesionale të AKK-së.

Me këtë ligj do të jetë që komunat në të ardhmen do të bëjnë themelimin dhe funksionimin e Komisionit Komunal për Ndërmarrje Publike Lokale, organ i cili do të jetë në kuadër të komunës dhe do të ushtroj të drejtën e aksionarit në raport me NPL. Gjithashtu komunat në rast të plotësimit të kriterëve të parapara mund të themelojnë NPL të reja me iniciativë nga Kryetari i Komunës përmes aprovimit nga Kuvendi Komunal. Këto ndryshime do të ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës për qytetarët e që janë përputhje të plotë me vizionin strategjik të AKK-së. Projektligji është në proces në Qeveri dhe të gjitha rekomandimet e propozuara nga ana e AKK-së janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektligj. Jemi në koordinim të vazhdueshëm dhe po i përcjellim vazhdimisht procedurat, presim miratimin në Qeveri dhe procesdimin për në Kuvendin e Kosovës.

1.6. Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Për disa vite me radhë AKK, ka lobuar dhe është angazhuar që projektligji të ndryshojë dhe të gjej miratim për ta ndryshuar situatën aktuale nëpër komuna në fushën e zhvillimit ekonomik. Edhe pse projektligji vitin e kaluar kishte kaluar të gjitha procedurat e miratimit në Qeveri, nuk është proceduar në Kuvendin e Kosovës, andaj përsëri këtë vit AKK është angazhuar që rekomandimet e propozuara të inkorporohen në projektligj, duke dhënë argumentet e nevojshme për të gjitha rekomandimet. Përsëri nuk është proceduar me propozimet e dhëna, por është hequr neni kryesor që i jepte mundësi kryetarëve të komunave të zhvillojë negociata me investitorët potencial, pa kaluar në procedurat e prokurimit apo ankandit publik, por pas negociimit dhe plotësimit të kriterëve të parapara në projektligj të dërgohet në Kuvendin e Komunës për miratim. Kjo ka shkaktuar mjaftë probleme andaj në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, kemi arritur që të kthehet neni për negociim dhe janë miratuar të gjitha propozimet e AKK në Komisionin parlamentar, pritet leximi i dytë dhe miratimi i komplet ligjit në Kuvendin e Kosovës.

1.7. Impakti i AKK-së në Këshillin për Zhvillim Ekonomik

AKK si pjesë e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ka vepruar në mënyrë direkte për të avancuar çështjet që kanë të bëjnë me komunat e për të cilat Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për përfundimin e tyre. AKK ka paraqitur aty kërkesat e bëra dhe rekomandimet në Ligjin për PPP dhe Ligjin për Dhënien e Tokës Komunale në Shfrytëzim, të cilat për një kohë të gjatë edhe pse të gjitha procedurat ligjore i kanë kaluar nuk është bërë finalizimi i tyre. Gjithashtu në këtë Këshillë AKK ka ngritur

problemin e komunave me menaxhimin e pronave të cilat janë pjesë e Ekonomisë Pyjore e që me projekt ligjin e ri do të kalojnë nën mbikqyrjen e Agjencionit të Pyjeve. AKK ka kërkuar që që ato prona të Ekonomisë Pyjore duhet të shërbejnë në interes publik dhe që këtyre pronave duhet të ju jepet një rëndësi më e madhe në mënyrë që të jenë në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, në interes të qytetarit e në përgjithësi në interes publik dhe të shtetit.

1.8. Koncepti dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Përmes mekanizmave të të AKK-së për një periudhë të gjatë është ngritur çështja e Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal (LFPL). Në vitet paraprake në bashkëpunim me Kolegjin për Buxhet dhe Financa dhe me të gjitha strukturat e tjera të AKK-së është zhvilluar një Koncept Dokument përmes të cilit është bërë identifikimi i mangësive në ligjin ekzistues dhe janë zhvilluar analiza në bazë të të cilave janë përcaktuar fushat të cilat duhet të ndërrohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Çështjet e ngritura nga Këshilli i Kryetarëve dhe Bordi i AKK-së, pas rekomandimeve të dhëna nga Kolegjiunet përkatëse profesionale ndryshimet e kërkuara nga AKK-ja janë: 1.Qartësimi i financimit të kompetencave që barten nga niveli lokal në atë qendror; 2.Përmirësim i përfaqësimit të zërit të komunave në Komisionin e Granteve; 3.Avancim i shërbimeve sociale dhe rezidenciale, përmes krijimit të grantit specifik për shërbime sociale; 4.Vendosje e kriterit të qartë për planifikimin e nivelit të hyrave vetjake komunale; 5.Vendosje e kriterëve të qarta dhe transparente për investimet e nivelit qendror në atë lokal; 6.Standarde dhe kriterë me të avancuara e të qarta për grantin specifik për arsim dhe shëndetësi; 7.Rritja e qëndrueshmërisë së financimit të komunave të vogla.

Këtë vit Ministria e Financave ka filluar me hartimin e Koncept Dokumentit për LFPL, dhe AKK-ja ka qenë e përfaqësuar në GP të emëruar nga kjo Ministri. Pas takimit të organizuar nga AKK në mes të Kolegjiunet për Buxhet dhe Financa të AKK-së me Ministrinë e Financave, rekomandimet e lartëcekura janë përcjellë tek GP dhe MF, dhe si të tilla janë inkorporuar në tërësi në verzionin e Koncept Dokumentit të miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe me këto propozime do të procedohet në ndryshimin e LFPL.

Performanca Organizative

AKK-ja ka respektuar plotësisht obligimet statutores: Është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor (janë zgjedhur Kryetari, Nënkryetari dhe Bordi), (ii) Bordi ka mbajtur 5 takime formale dhe disa jo-formale dhe Këshilli i AKK-së është takuar më shumë se 5 herë gjatë këtij viti.

Kolegjiunet Profesionale – mbeten një mbështetje e fortë në diskutimin e projektligjeve dhe akteve të ndryshme nënligjore në interes të komunave, të cilat veçohen në strategjinë legjislativë. Këto mekanizma janë struktura unifikuese të pushtetit lokal në Kosovë. Kolegjiunet merren me shqyrtimin dhe diskutimin e temave të ndryshme me interes komunal, duke përfshirë nxjerrjen e rekomandimeve dhe kërkesave për qeverinë qendrore me qëllim të përmirësimit të shërbimeve komunale.

Secili Kolegjiun i AKK-së harton planin e saj vjetor i cili përfshin prioritetet, angazhimet dhe objektivat, bazuar në agjendën legjislativë të qeverisë qendrore. Përveç konsolidimit me struktura të reja, secili

kolegjium ka mbajtur së paku 6 takime ndërsa janë mbajtur më shumë se 45 takime të kryesive të Kolegjiumeve. Janë zhvilluar së paku dy qëndrime për secilin Kolegjium.

Performanca financiare

Në aspektin financiar, gjatë gjysmë vitit 2018 AKK-ja ka arritur që të inkasojë € 183,799.81 nga taksa për anëtarësim, dhe ka realizuar 132 % të objektivit të paraparë prej € 140,000 të planifikuar për vitin 2018. Gjatë kësaj kohe është vërejtur një gatishmëri e lartë e Komunave në kryerjen e obligimeve sa i përket pagesës së anëtarësisë. Nga totali i Komunave, anëtare të AKK-së, deri me tani 28 prej tyre, kanë kryer plotësisht dhe vetëm katër (4) pjesërisht. Kjo mund të konsiderohet një e arritur duke marrë parasysh që në vitin 2017 kishte zgjedhje lokale, ku në shumë komuna kemi kryetarë e struktura të reja komunale, e megjithatë AKK ka arritur që të ruaj kontinuitetin optimal në realizimin e këtij objekti. SDC vazhdoi të jap kontributin e saj thelbësor në AKK, si partner kryesor institucional.

Komunikimi, raportet me komunat dhe partnerët

Gjatë gjithë vitit, AKK-ja ka vazhduar të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në përgjithësi, komunave u janë dërguar 90 njoftime të ndryshme, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj. Uebfaqja e AKK-së është azhuruar në baza ditore ku të gjitha lajmet dhe aktivitetet e AKK-së janë vendosur rregullisht në faqen e Facebook. Statistikat tregojnë që gjatë vitit 2018 uebfaqja e AKK-së ka pasur 49,738 vizita gjithsej, me një mesatare mujore prej 4,144 vizitash. Po ashtu, marrë parasysh publikimet periodike, AKK-ja përpilon dhe shpërndan Buletin e vet, të vetmin për pushtetin lokal në baza dymujore, e cila publikohet në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht). Në këtë periudhë vjetore janë përgatitur publikuar dhe shpërndarë gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë përmes produkteve identifikuese. Në këtë drejtim AKK-ja ka faqen e vet 'Facebook', ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja. Gjatë vitit 2018 janë mbi 135 postime në 'facebook' me 2500 deri në 5300 'shikime' për postim.

Bashkëpunimi me partnerë, AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, si dhe në realizimin e shumë projekteve ku komunat kanë përfituar drejtpërdrejtë qoftë në fonde, përkrahje financiare, projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime, punëtori, shkëmbim të përvojave etj.

Projektet u impelmentuan në bashkëpunim me DEMOS, GIZ, NALAS, OSBE, TEAM/USAID, UNHABITAT, GIZ/Open Regional Fund and European Commission. AKK-ja ka vazhduar t'i përfaqësoj qëndrimet dhe interesat e komunave dhe të kontribuoj tek koordinimi i donatorëve me pjesëmarrjet e rregullta në takimet e Komitetit Drejtues të projekteve të rëndësishme të donatoreve në fushën e Qeverisjes Lokale dhe Shërbimeve Komunale, siç janë SDC/DEMOS, SDC/RWSSP, GIZ/SMS, etj.

Përveç kësaj, është organizuar takimi "Miq të AKK-së" me partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët punojnë në fushën e qeverisjes lokale.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së PËR VITIN 2018

Edhe gjatë vitit 2018, Asociacioni i Komunave të Kosovës punoi bazuar në objektivat e saj të përcaktuara në Strategjinë e re 2016/2020 dhe Planin Vjetor të AKK-së. Objektivat kryesore për vitin 2018 ishin:

- Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të komunave përmes Lobimit dhe Avokimit,
- Ofrimi i shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimi i performancës së Komunave,
- Funksionaliteti i strukturave të AKK-së,
- Qëndrueshmëria financiare,
- Bashkëpunimi me partnerët duke mbajtur AKK si pikë-referim,
- Komunikimi me komunat dhe përmirësimi i performancës të administratës së AKK-së.

3. ZHVILLIMI DHE KONSOLIDIMI I POLITIKAVE (QËNDRIMEVE)

Në vazhdim të procesit të deritanishëm, Asociacioni i Komunave të Kosovës synoi që përmes strukturave të saj sikurse janë: Bordi, Këshilli i Kryetarëve, Kolegjiumet dhe Komisionet, të konsolidojë qëndrimet e veta karshi institucioneve qendrore me synim zhvillimin e politikave të cilat do të ndihmonin në fuqizimin e rolit të vazhdueshëm të komunave.

Në këtë vit, lobimi i AKK-së ka qenë i përqendruar në disa çështje me prioritet për komunat sikurse janë:

1. Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
2. Projektligji për Zyrtarët Publik;
3. Projektligji për Pagat;
4. Projektligji për Ndërmarrjet Publike;
5. Projektligji për Miniera dhe Minerale;
6. Koncept Dokumenti për Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal.

Në këtë drejtim, AKK-ja rregullisht ka takuar Bordin dhe Kolegjiumet për të diskutuar planet vjetore të punës, prioritetet e angazhimeve dhe synimeve bazuar në agjendën legjislative të Qeverisë Qendrore. Në kuadër të planeve vjetore të Kolegjiumeve ka trajtuar me seriozitet angazhimet e vazhdueshme në implementimin e Strategjive të Kolegjiumeve përmes implementimit të Strategjisë së AKK-së 2016/2020.

4. LOBIMI DHE AVOKIMI

Agjenda legjislative dhe kyqja e AKK-së

Viti 2018, mund të konsiderohet mjaft produktiv sa i përket fushës së legjislacionit, pasi që Qeveria ka proceduar me mjaft projektligje, e që AKK-ja është pjesë e njëzet (20) projektligjeve për vitin 2018. Nga 75 projektligje sa ka paraparë agjenda legjislative për këtë vit AKK, ka paraqitur kërkesë të jetë pjesë e procesit në pesëmbëdhjet (15) prej tyre, po ashtu katër (4) projektligje janë bartuar nga viti 2017, ku AKK-ja është anëtare në grupet punuese si dhe jemi kyqur edhe në një (1) projektligj që ishte nismë e Kuvendit të Kosovës, pra AKK është e kyçur në grupe punuese, ku lobon, jep rekomandime dhe paraqet kërkesat e komunave.

Shumica e propozimeve, kërkesave dhe rekomandimet të AKK-së janë inkorporuar në projektligje, dhe disa prej tyre janë para miratimit në Qeveri, disa para miratimit në Kuvend të Kosovës dhe disa ende janë në proces të punës.

Angazhimi i jonë, bashkëpunimi i shkëlqyer me institucionet e Kosovës si dhe përvoja shumë vjecare kanë ndikuar që të kemi sukses në fushën e lobimit në hartim dhe plotësim-ndryshim të legjislacionit çka tregon edhe pjesëmarrja e jonë në shumë grupe punuese, me theks kyçja e AKK-ja në të gjitha fazat e procesit të hartimit të legjislacionit deri në fazën e miratimit.

Ajo çka e bën edhe më të dalluar suksesin tonë, në disa projektligje, AKK-ja është konsideruar anëtar i denjë profesional për nenet që i takojnë nivelit lokal të i hartojë vetë dhe të i propozojë në grupin punues, duke i arsyetuar që të pranohen si të tilla edhe nga anëtarët tjerë të grupeve punuese.

Vlen të ceket bashkëpunimi i shkëlqyer i AKK-së me Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Kosovës, ku të gjitha propozimet e AKK-së janë trajtuar bashkarisht dhe pastaj janë miratuar nga ana e deputetëve.

Përveç agjendës legjislative, AKK ka lobuar edhe për çështjet ad-hoc, të cilat kanë ndikuar mjaft shumë në aspektin financiar tek komunat si dhe në çështjet që po janë sfida të vazhdueshme për nivelin lokal.

4.1. Përsëri ndalohet Akademia për Vetëqeverisje Lokale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka mirëkuptuar dhe pranuar kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) për të mos themeluar Akademinë për Vetëqeverisje Lokale, që ishte paraparë në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe si objektivi i inkorporuar në Planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin 2017.

Pas përpjekjeve të reja (2017 - hera e parë dhe 2018 - hera e dytë), AKK ka reaguar ndaj një iniciative të tillë si e pa nevojshme dhe si dyfishim i punës së institucioneve ekzistuese relevante për këtë fushë, siç është Instituti Kosovar i Administratës Publike dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, të cilat me ligj janë të parapara si institucione të cilat ofrojnë shërbime për ngritjen të kapaciteteve në nivelin komunal. Reagimi i AKK-së në këtë iniciativë me kohë dhe roli i AKK-së si kujdestar parandalues i zhvillimeve të cilat nuk janë në harmoni me qëllimet e avancimit të pushtetit lokal në Kosovë, ka tërhequr vëmendjen e institucioneve relevante të thirrura për ngritje të kapaciteteve në Kosovë, si dhe një reagim i tillë ka mundësuar komunitetit të donatorëve në pushtetin lokal të jetë në dijeni me iniciativat të cilat do të ishin dyfishim i aktiviteteve ekzistuese në këtë fushë dhe ngarkesë e pa nevojshme e buxhetit në përgjithësi.

Ky reagim argumentues i AKK-së ka hasur në mirëkuptim të institucioneve përkatëse dhe të donatorëve dhe formimi i kësaj Akademie është ndaluar. Poashtu në formën e propozuar kishte tendenca për zbehjen e rolit të AKK-së në fushën e ngritjes së kapaciteteve për komunat e Kosovës.

4.2. Peticioni si formë e re presioni

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka organizuar peticionin për rregullimin meritore të çështjes së të ardhurave të Anëtarëve të Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe pjesës tjetër komunale. Ky peticion është përkrahur nga të gjithë kryetarët, drejtorët, anëtarët e KK-ve pa marrë parasysh përkatësinë politike dhe etnike. Menjëherë pas organizimit të peticionit, institucionet qendrore kanë reaguar duke avancuar në prioritet çështjen e rregullimit të kësaj teme me projektligjin e pagave

që ishte në procedurë e sipër. Për këtë edhe Ministri i MAP-it ka marrë pjesë në takimin e Këshillit të Kryetarëve ku është dakorduar me gjitha kërkesat e komunave sa i përket kësaj çështje.

Organizimi i petitionit dhe presioni përmes tij është formë e re e avokimit të çështjeve komunale, e i cili dha rezultatin e vetë. Reagimi i shpejtë nga ana e institucioneve qendrore tregon sa për fuqinë që ka organizimi unik i pushtetit lokal përmes AKK-së aq edhe për arsyeshmërinë e këtyre kërkersave nga ana e komunave.

Si rezultat i angazhimeve të AKK-së, kategoria e Anëtarëve të Kuvendit të Komunave për herë të parë hyri në Projektligjin e pagave. Ky Projektligj do të rregullojë pagat e të gjithë të emëruarve politik, funksionarëve publik dhe zyrtarëve publik, si i tillë pra ka përfshirë të gjitha kategoritë që marrin paga nga buxheti i shtetit të Kosovës. AKK e ka shqyrtuar projektligjin për paga me Kolegjiunet Profesionale dhe ka bërë edhe analiza konkrete duke krahasuar pagat e zyrtarëve të nivelit qendror dhe të nivelit lokal dhe kemi kërkuar që për punë të njëjtë të ketë pagë të njëjtë. Andaj propozimet tona po thuhet shumica janë pranuar duke i trajtuar së pari me pagë dinjitoze kryetarët e komunave, drejtorët e drejtorive, kryesuesit e kuvendeve të komunave, **anëtarët e Kuvendeve të Komunave** dhe zyrtarët publik. Projektligji është miratuar në Qeveri pastaj ka kaluar në procedurat e Kuvendit të Kosovës, ku është mbajtur edhe debat publik, në të cilin kemi dhënë propozimet konkrete dhe kemi kërkuar disa ndryshime të cilat janë pranuar dhe presim miratimin e tyre në Komisionin parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe pastaj edhe miratimin në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

4.3. Impakti i AKK-së në Këshillin për Zhvillim Ekonomik

AKK si pjesë e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ka vepruar në mënyrë direkte për të avancuar çështjet që kanë të bëjnë me komunat e për të cilat Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për përfundimin e tyre. AKK ka paraqitur aty kërkesat e bëra dhe rekomandimet në Ligjin për PPP dhe Ligjin për Dhënie të Tokës Komunale në Shfrytëzim, të cilat për një kohë të gjatë edhe pse të gjitha procedurat ligjore i kanë kaluar nuk është bërë finalizimi i tyre. Gjithashtu në këtë Këshillë AKK ka ngritur problemin e komunave me menaxhimin e pronave të cilat janë pjesë e Ekonomisë Pyjore e që me projekt ligjin e ri do të kalojnë nën mbikqyrjen e Agjensionit të Pyjeve. AKK ka kërkuar që që ato prona të Ekonomisë Pyjore duhet të shërbejnë në interes publik dhe që këtyre pronave duhet të ju jepet një rëndësi më e madhe në mënyrë që të jenë në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit, në interes të qytetarit e në përgjithësi në interes publik dhe të shtetit.

4.4. Miliona euro më shumë për komunat nga lobimi i AKK-së

Përfaqësuesit e AKK-së anëtar të Komisionit të Granteve në Ministrinë e Financave, në takimin ku është shqyrtuar edhe Korrniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), janë ngritur disa problematika të cilat do të duhej të rregullohen me anë të buxhetit.

Njëra ndër çështjet e ngritura ishte çështja e Granti Specifik për Arsim, ku u cek që numri i nxënësve në Kosovë është duke u zvogëluar për 10,000 çdo vit dhe për këtë arsye është kërkuar që të zvogëlohet edhe numri mësimdhënësve në komuna.

Përfaqësuesit e AKK-së në Komisionin e Granteve rreth kësaj problematike kërkuan që numri i mësimdhënësve në shkolla të mos përcaktohet në proporcion me numrin e nxënësve, por të përcaktohet në bazë të normës së paraparë për mësimdhënës, në mënyrë që buxheti për arsim mos të ulet si pasojë e zvoglimit të numrit të nxënësve.

Gjithashtu në Komisionin e Granteve u diskutua problematika e pagave jubilarë, e cila po i'u kushton buxheteve komunale. Dhe në këtë takim MF është zotuar se kjo do të mbulohet për komunat të cilat bëjnë planifiket buxhetore me kohë.

- Për dallim nga viti 2018 buxheti për komunat e Kosovës për vitin 2019 do të jetë 517,57 milion euro, pra për 35 milion euro më shumë ose për 8% më i lartë,
- Dallimi në mes të vitit 2018 dhe vitit 2019 është që komunat do të kenë 5% më shumë buxhet ose 7,1 milion EURO në grantin e përgjithshëm,
- Granti Specifik për Arsim parashihet të jetë për 10% më i lartë në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ose për 17,1 milion EURO më shumë,
- Granti Specifik për Shëndetësi parashihet të jetë për 10% më i lartë në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 ose për 5 milion EURO më i lartë,
- Projektionet për të hyra vetanake në komuna për vitin 2019 do të jenë 5 milion EURO (6%) më të larta në krahasim me vitin 2018.

4.5. Renta minerare 20 %, do të ju ndahet komunave ku operojnë bizneset

Konteksti

Meqenëse “Projekligji për Miniera dhe Minerale” ishte nismë e Kuvendit të Kosovës, ne filluam lobimin në Kuvend të Kosovës, zhvilluam takime me administratën, me Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, mbajtëm punëtori së bashku dhe në fund dolëm me propozime konkrete, se në projekligj duhej rregulluar disa nene që ndërlidheshin me nivelin lokal. Ajo cka kishte rëndësi të madhe ishte që komunat në të cilat operonin bizneset për minera dhe minerale të përfitonin një përqindje të caktuar meqenëse në teritorin e asaj komune shkaktoheshin punime në tokë, kishte edhe pengesa për banorët dhe ndotjej ambienti i asaj zone. Në dëmshpërblim të këtyre dëmeve të iu kthehej komunave një investim që do të përfitonin banorët në disa fusha kryesore, si në shëndetësi, arsim, mjedis, kulturë e sport.

Të arriturat

Propozimet e AKK-së, ishin konkrete të bazuara edhe në praktika të rajonit dhe cka ishte më kryesore ishin mjaft të argumentuara. Kështu që ne arrimet që amandamenti i propozuar të inkorporohej në projekligj. “Rentat minerare të mbledhura nga Komisioni për Miniera dhe Minerale janë të hyra të përgjithshme të buxhetit të Republikës së Kosovës. Njëzet përqind (20%) e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin e Komunës ku zhvillohet aktiviteti minerar, i dedikuar në mënyrë specifike në zhvillim të komunitetit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastruktures, sportit, shëndetësisë dhe arsimit”.

Impakti

Duke pasur parasysh që jeta zhvillohet nëpër komuna, qytetarët ballafaqohen me ato dëme, të cilat ndikojnë në shëndet, në mjedis, në arsim, në infrastrukturë etj. po ashtu edhe komunat duhet më shumë të ju dalin në ndihmë qytetarëve andaj një pjesë e rentës do të zgjidh këto çështje dhe komunat do të kenë mundësi të zhvillimit të jetës më të mirë për qytetarët. Pra komunat do të përfitojnë njëzet përqind (20 %) nga renta minerare e që kjo shumë mund të kap shifrën deri në 12 milion euro në vit.

4.6. Projektligji për Ndërmarrjet Publike

Konteksti

AKK ka qenë pjesë e Grupit Punues për hartimin e Projekt Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ligj i cili është i një rëndësie të veçantë për komunat duke pasur parasysh që me këtë ligj rregullohet funksionimi i Ndërmarrjeve Publike Lokale, i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon në avancimin e shërbimeve për qytetarët. Si pjesë e këtij Grupi Punues në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si sponzorizuese e këtij ligji, përmes takimeve me Kolegjiunet e caktuara, AKK-ja e ka mbajtur qëndrimin e saj si zë i komunave të Kosovës, duke i paraqitur shqetësimet e komunave në qeverinë qendrore rreth problematikave aktuale të funksionimit të NPL-ve ekzistuese në komunat përkatëse. Ligji paraparak nuk ka qenë i favorshëm për komunat sidomos rreth rolit të mekanizmit komunal përmes të cilit komuna ka ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarit në NP lokale, mekanizëm i cili është dashur të mbikëqyrë dhe raporton rreth funksionimit të ndërmarrjeve publike lokale. Gjithashtu me Ligjin paraparak procedurat e themelimit të ndërmarrjeve publike lokale të reja kanë qenë më të komplikuar, e të cilat kanë penguar iniciativat për themelimin e NPL-ve të reja.

Të arriturat

AKK në rethanat aktuale në Kosovë respektivisht në çështjet e avancimit të pushtetit lokal e ka dëshmuar veten si fleksibile dhe të përgjegjshme ndaj temave dhe shqetësimeve të reja sa herë që paraqiten ato për komunat e saj anëtare. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si përgjegjëse për hartimin e këtij projektligji, duke i marrë parasysh të gjitha këto si dhe të arriturat e deritanishme në shtyerjen përpara të çështjeve në të mirë të komunave, ka konsideruar rolin e AKK-së si përfaqësues unik i komunave. Si rezultat i gjithë kësaj në GP për hartimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, MZHE nga AKK si anëtare e GP ka kërkuar që dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me komunat, të hartohen dhe formulohen ekskluzivisht nga AKK, proces i cili është kompletuar përmes strukturave përkatëse profesionale të AKK-së. Kjo është një arritje tjetër, është një hap tutje nga përvojat paraprake ku AKK ka qenë e përfshirë si organizatë që ka dhënë rekomandime në ligje të ndryshme. Kurse e arritur konkrete në këtë ligj do të jetë që komunat në të ardhmen do të bëjnë themelimin dhe funksionimin e Komisionit Komunal për Ndërmarrje Publike Lokale në kuadër të komunës organ i cili do të jetë në kuadër të komunës dhe do të ushtror të drejtën e aksionarit në raport me NPL. Gjithashtu komunat në rast të plotësisimit të kritereve të parapara mund të themelojnë NPL të reja me iniciativë nga Kryetari i Komunës përmes aprovimit nga Kuvendi Komunal.

Impakti

Të gjitha ndryshimet e hartuara për Projektligjin për Ndërmarrjet Publike nga ana e AKK-së në dispozitat e këtij ligji e që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike komunale janë inkorporuar plotësisht në draft ligjin e ri. Përmes këtyre ndryshimeve funksionimi i NPL-ve lokale mund të mbikëqyret në mënyrë profesionale nga Komisioni Komunal si aksionar i NPL-ve, si dhe të krijohet klimë më e favorshme për iniciativa të reja në komuna për themelimin e NPL-ve të reja aty ku shihet si e nevojshme. Përmes bashkërendimit të aktiviteteve të lobimit me qëllim të harmonizimit të legjislatcionit në shërbim të komunave dhe në vazhdimësi duke promovuar interesat e komunave, këto ndryshime do të ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës për qytetarët e që janë përputhje të plotë me vizionin strategjik të AKK-së.

4.7. Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

Konteksti

Ishte kërkesë e AKK-së prej disa viteve me radhë që ky ligj duhet të ndryshojë për arsye se është e nevojshme për komunat një qasje më e arsyeshme dhe më e plotësuar që duhet të sjell ky ligj në fushën e zhvillimit ekonomik. Meqenëse MAPL nuk e kishte proceduar vitin e kaluar këtë projektligj për miratim në Qeveri, përsëri këtë vit projektligji ishte në agjendën legjislative. AKK paraqiti propozimet konkrete, por përsëri nuk u dërguan si të plota për miratim, andaj AKK përmes bashkëpunimi të mirë me Kuvendin e Kosovës arriti që të fuste në projektligj rekomandimet e propozuar të cilat i ka argumentuar në mënyrë profesionale.

Të arriturat

Pa mëdyshje se kjo është e arritura kryesore që AKK-ja ka dhënë kontribut në grupin punues, ka paraqitur kërkesat e komunave me propozimet konkrete të argumentuara, sidomos nenit kryesor për zhvillim të negociatave në mes të kryetarit të komunës dhe investitorëve potencial.

Negocimi për mes kryetarit të komunës do jetë risi në këtë ligj, pastaj dhënia e pronës për afat deri në një vit do të rregullohet me rregullore komunale, dhënia e pronës për raste të veçanta do të ketë ndryshime dhe do të jetë konform planit zhvillimor të komunës, afatet do të shkurtohet dhe mënyra e votimit do të jetë më votim 2/3 të anëtarëve prezent në seancë dhe që votojnë. Këto propozime janë miratuar në Komisionin parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, pritet vetëm miratimi i projektligjit në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Impakti

Komuna qëllim kryesor e ka zhvillimin ekonomik si interes publik, andaj ky ligj do të u jep mundësi më të madhe për një zhvillim ekonomik më të avancuar dhe në interes të qytetarëve. Ndryshimi i këtij ligji duke marrë parasysh rekomandimet e AKK-së, komunave do të i'u lehtësonte procedurat, do të i'u mundësonte me shumë marrëdhënie kontraktuale me biznese të cilat do të ndikonin në zhvillimin e komunës, në punësim e të rinjve dhe në performancën e komunës në përgjithësi. AKK-ja konsideron që me këto ndryshime komunat do t'a kenë me lehtë në të ardhmen për të bërë më atraktiv ambientin për investime të huaja dhe vendore. Projektligji ka kaluar shumicën e procedurave dhe pritet leximi i dytë dhe miratimi në Kuvendin e Kosovës.

4.8. Koncept dokumenti për Financat e Pushtetit Lokal

Konteksti

Ligji i Financave të Pushtetit Lokal (LFPL) pas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale është akti ligjor më i rëndësishëm për Komunitet e Kosovës. Për shkak të rrethanave të krijuara dhe avancimit të komunave të Kosovës në shumë aspekte, ligji ekzistues sipas atyre të cilët janë zbatues të këtij ligji, nuk është në nivel me kërkesat dhe nevojat aktuale të komunave. Një fakt i tillë është ngritur disa herë nga Kolegjiumet profesionale të AKK-së si problematikë në funksionimin e duhur të komunave. Bartja e kompetencave nga niveli qendror i percjellur me financimin adekuat tek niveli lokal, funksionimi i komisionit të granteve, formula e grantit specifik për Arsim dhe Shëndetësi si dhe krijimi i një granti të veçantë për shërbime sociale etj., janë disa nga fushat e rregulluara me LFPL dhe të cilat nuk kanë gjetur zbatueshmërinë e duhur në komunitet e Kosovës. Për këtë arsye AKK-ja përmes strukturave të veta ka insistuar që ky ligj të amendamentohet dhe kërkesat e komunave të merren parasysh.

Të arriturat

Pas takimit vitin e kaluar të përfaqësuesve të AKK-së me ish Ministrin e Financave (MF), ku u paraqitën konceptet e komunave rreth ligjit ekzistues dhe nevojave për ndryshim në pika të caktuara, këtë vit MF filloi me hartimin e koncept dokumentit për LFPL si hapa paraprak për ndryshimin e tij dhe në Grupin Punues për Koncept Dokumentin ka marrë pjesë edhe AKK. Procesi i zhvillimit të tij nga Grupi Punues në vazhdimësi është percjellur dhe diskutuar me Këshillin e Kryetarëve dhe me Kolegjiumet përkatëse të AKK-së, dhe janë dhënë sugjerimet e nevojshme në mënyrë që në Koncept Dokument të përfshihen rekomandimet e komunave. E arritura kryesore është që të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e AKK-së janë marrë parasysh nga Grupi Punues dhe MF dhe plotësisht janë inkorporuar në Koncept Dokumentin dhe si të tilla janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe tutje do të procedohet me ndryshimin e LFPL-së.

Impakti

Me këtë akt ligjor do të përmirësohet funksionimi i duhur i Komisionit të granteve si organ i komunikimit direkt të nivelit qendror me nivelin lokal, qartësimi i kompetencave dhe obligimeve financiare mes nivelit qendror dhe atij lokal. Pastaj percaktimi i qartë i mënyrës së ndarjes së buxhetit për komuna për Arsim dhe Shëndetësi në bazë të kriterëve të percaktuara me formulë të re, granti i ri specifik për shërbime sociale dhe mënyra e parashikimit të hyrave vetiaku nga komunitet në bashkëpunim me MF-në do të rezultojnë në funksionim dhe rregull financiar të avancuar për komunitet.

Mënyra e e qartë e alokimit të buxhetit nga qeveria për komunitet, do të mundësoj percaktimin më të mirë të komunave të prioriteteve strategjike dhe proceset e avancuara të menaxhimit me financa në komuna do të u lehtësoj atyre në masë të madhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët e saj.

5. PUNA E KOLEGJIUMEVE PËR SHËRBIME NDAJ KOMUNAVE

5.1. Kolegjiumet Profesionale

Pas përfundimit të zgjedhjeve lokale të fundvitit 2017, të gjitha Komunat e Kosovës kanë filluar ngritjen e strukturave të reja e të cilat do të udhëheqin komunat e tyre në mandatin e ardhshëm katër vjeçar në përbërjen e drejtorëve të drejtorive udhëheqëse.

Duke u bazuar në organizmin e strukturave të themeluara nga AKK-ja, në përbërje të Kolegjiumeve profesionale e të cilat formohen nga drejtorët e drejtorive përkatëse në komuna, janë zhvilluar zgjedhjet e kryesive të reja dhe të kryesuesve e të zëvendës kryesuesve të Kolegjiumeve. Këto kolegjiume të veçanta merren me shqyrtimin dhe diskutimin e temave të ndryshme të interesit komunal duke përfshirë dhënien e rekomandimeve qeverisë qendrore për të shqyrtuar kërkesat e bëra nga autoritetet komunale për mbrojtjen e kompetencave të tyre dhe përmirësimin e shërbimeve komunale. Gjithashtu në këtë proces janë aprovuar për të gjitha këto Kolegjiume, "Rregulloret e Punës" si bazë e zhvillimeve për veprimtarinë e këtyre Kolegjiumeve në mandatin e ardhshëm.

Në funksion të veprimtarive vjetore Kolegjiumet kanë aprovuar planet e punës, duke u bazuar në Strategjinë e AKK-së 2016-2020, në përcaktimin e prioriteteve të punës, me objektiv për të koordinuar dhe zhvilluar aktivitetet e tyre. Diskutimi i Strategjisë Legjislative ka një peshë dhe vëmendje të veçantë me synim identifikimin e temave të rëndësishme e të cilat janë në interes të punës së Kolegjiumeve në fushat e tyre përkatëse për mbrojtjen e kompetencave dhe përmirësimin e shërbimeve komunale

Me qëllim ngritjen e profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve, numri i kolegjiumeve dhe grupeve punuese të përbërë nga zyrtarë komunal është shtuar këtë vit me Grupin Punues të zyrtarëve komunal për menaxhim të mbeturinave, Grupin Punues për efikasitet të energjisë, gjithashtu Kolegjiumi i Menaxherëve të Prokurimit ka vazhduar punën si trupë e re e formuar në fund të viti të kaluar. Qëllimi i formimit të këtyre Grupeve Punuese është qasja ndaj problematikave në komuna nga pikëpamja e zyrtarëve komunal e që në bashkëpunim me Kolegjiumet përkatëse do të avancojnë punën në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve për qytetarë. Nga aktiviteti i zgjedhjeve të kryesuesve të Kolegjiumeve në kuadër të programit të AKK-së kemi tetë (8) femra të cilat do të kenë përgjegjësinë në udhëheqjen e punës së Kolegjiumeve, kurse pesë (5) prej tyre janë zëvendës kryesuese, gjersa të gjitha Kolegjiumet në Kryesitë e tyre kanë nga së paku një femër. Ky numër i rritur i Kryesuesve është si rezultat i respektit të ndërsjellë kolegjal dhe barazisë gjinore dhe paraqet 50% të Kryesuesve të Kolegjiumeve në programin e AKK-së.

Për të gjithë Drejtorët të cilët e ushtrojnë për herë të parë këtë funksion, AKK ka prezantuar para tyre rolin e vetë në përgjithësi, mënyra e funksionimit të punës së Kolegjiumeve dhe rëndësia e tyre për Komunat e Kosovës.

Pas integritit në funksionet e reja, Kolegjiumet gjatë këtij viti kanë shqyrtuar një mori aktesh nënligjore, të cilat ndërlidhen me zbatimin e ligjeve që rregullojnë kompetencat e komunave. Kolegjiumet i kanë trajtuar aktet nënligjore në aspektin, juridik, financiar, profesional dhe administrativ, varësisht prej fushës që mbulon Kolegjiumi.

Në rol të shqyrtimit dhe diskutimit e temave të ndryshme me interesi komunal, e të cilat ndërlidhen me zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nën/ligjore, AKK-ja mbështet komunat duke organizuar takime midis përfaqësuesve të ministrive të ndryshme dhe Kolegjiumeve të AKK-së në diskutimin e temave të

ndryshme duke përfshirë dhënien e rekomandimeve si pjesë e debatit nga autoritetet komunale për mbrojtjen e kompetencave të tyre dhe përmirësimin e shërbimeve komunale.

Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor: Meqenëse fusha e legjislacionit është pjesë e punës së këtij kolegji, të gjitha projektligjet të cilat janë shqyrtuar për këtë vit janë diskutuar dhe kanë dalë me rekomandime se çfarë duhet ndryshuar apo propozuar në ato projektligje. Po ashtu janë shqyrtuar edhe aktet nënligjore. Si kërkesë e komunave ishte hartimi i një model-rregulloreje për shërbimet publike, duke i përfshirë gjobat sipas Ligjit për Kundërvajtje. AKK ka organizuar punëtori dhe kryesia e Kolegjiumit ka hartuar “Model rregulloren për shërbimet publike- duke përfshirë gjobat sipas Ligjit për Kundërvajtje”, e cila është përkthyer dhe iu është shpërndarë të gjitha komunave në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Ky Kolegjium bashkëpunon edhe me kolegjiut tjera lidhur me ofrimin e këshillave ligjore, apo hartimin e dokumenteve të ndryshme të nevojshme për komunat. Ky kolegjiut ka mbështetur financiare të OSBE-së dhe ka mbajtur gjashtë (6) takime të rregullta, tri (3) punëtori, ka mbajtur trajnime për të gjithë zyrtarët ligjor të komunave dhe ka marrë pjesë edhe në takime të kolegjiut tjera kur janë shqyrtuar projektligjet. Sipas planit të punës është realizuar edhe trajnimi për zyrtarët ligjor të të gjitha komunave në bashkëpunim me OSBE-në.

Kolegjiumi i Udhëheqësit e Personelit: duke vlerësuar rëndësinë e madhe të pakos legjislative sa i përket diskutimit të Projektligjit për Zyrtarët Publik, Projektligjit për Paga, si dhe Projektligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore, udhëheqësit e personelit kanë nënvizuar rëndësinë që reforma e administratës publike ka të bëjë me ndërtimin e një administrate publike si masë e domosdoshme në përcaktimin e një sistemi efikas të menaxhimit administrativ me qëllim organizimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, efikas dhe profesional. Këto tre projektligje janë shtyllat e procesit të reformimit dhe modernizimit të administratës publike me qëllim ngritjen profesionale të administratës publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarit. Përmes përkushtimit dhe kujdesit të veçantë janë trajtuar nga Kolegjiumi, përmbajtja e drafteve aktuale të pakos për reformën e administratës publike me qëllim koordinimin e qëndrimeve dhe dhënien e këshillave lidhur me zbatimin e tyre, ndërlikimet e mundshme sa i përket kapaciteteve njerëzore për t’i shërbyer në mënyrë efektive të gjithë qytetarëve.

Kolegjiumi për Shërbimet Publike: vazhdojnë angazhimin në sektorë të ndryshëm me rëndësi në ofrimin e shërbimeve komunale, duke përmendur vazhdimin e përkrahjes përmes programit të Fondit Rajonal për Eficiencë të Energjisë (GiZ/ORF) në hartimin e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban dhe përmirësimin e lëvizshmërisë urbane, Projektit Rajonal RCDN për Ujë dhe Shërbime të Kanalizimit si dhe Komisionit Evropian/GFA – sa i përket Planeve Komunale për Eficiencë të Energjisë.

Përmirësimi i veprimtarisë së Ndërmarrjeve Publike Lokale paraqet sfidë të veçantë për komunat, andaj si shumë i rëndësishëm është marrë shqyrtimi i këtij projektligji i cili do të ushtron të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionarit në Ndërmarrjet Publike Lokale, në funksion të mbikëqyrjes dhe raportimit lidhur me punën e këtyre ndërmarrjeve. Pas një debati të gjerë KSHP ka dalë me qëndrime konkrete sa i përket çështjeve që janë në kompetencë të komunave e ku janë përfshirë të gjitha propozimet që ndërlidhen me kompetencat e nivelit lokal. AKK-ja ka konsideruar si një projektligj shumë i kënaqshëm ku ka lehtësuar në masë të madhe procedurat për themelimin të ndërmarrjeve publike lokale dhe i ka

kthyer kompetencat te kryetari, pra ekzekutivi do të jetë mbikëqyrësi kryesor i ndërmarrjeve publike lokale përmes aksionarëve që do të emërohet nga Kryetari i Komunës.

Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor: Kolegjiumi për Planifikim me kujdes është përfshirë në diskutimin e Projekt Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa Leje në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në Kuvendin e Kosovës. Përmes vërejtjeve dhe sugjerimeve nga ana e Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor për ndryshimin e Ligjit aktual, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka paraqitur draftin në konsultim e ku janë përfshirë edhe komentet dhe vërejtjet e Kolegjiumit në thjeshtimin e procedurave për legalizim, uljen e kostos dhe regjistrimin përfundimtar të pronës në dokumentet kadastrale. Pas diskutimeve të gjata grupi punues për trajtimin e ndërtimeve pa leje i ka trajtuar të gjitha vërejtjet me amandamentimin e këtij procesi, në veçanti pranimi teknik i objekteve do të kryhet shumë më lehtë në mënyrë që tu bëjë më të lehtë qytetarit legalizimin e objekteve aktuale të ndërtuara pa leje. Njëra ndër vërejtjet që shohin Komunitat në këtë proces do të jetë edhe mungesa e financave dhe stafit komunal që do të jetë përgjegjës për trajtimin e ndërtimeve pa leje e po ashtu ky proces duhet të mbështet me një fushatë ndërgjegjësimi nga MMPH-ja, për të gjithë procesin e legalizimit në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar për detyrat dhe përgjegjësitë në procesin e legalizimit. Njëra ndër angazhimet në të ardhmen paraqitet edhe ofrimi i shërbimeve i pajisjes së qytetarit me leje ndërtimore të bëhet përmes komunikimit elektronik prej ueb-faqeve komunale.

Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik: përmes lobimit të vazhdueshëm rreth ndryshimit të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, po mundësohet që për mes këtij ligji t'i jap hov zhvillimit ekonomik lokal, me qëllim krijimin kushteve sa i përket dhënies së pronës për afat deri në një vit e cila vendoset me rregullore komunale, dhënia e pronës për raste të veçanta do të ketë ndryshime do të jetë në përshtatje të planit zhvillimor të komunës. Gjetja e formave të thjeshtësimit të procedurave të parapara në mënyrë që komunitat të jenë më tërheqëse për investitorët potencial, përmes projekteve të PPP mbetet objektiv në interes të komunave qëllim të shmangies së procedurave burokratike dhe kohore të cilat janë të nevojshme deri te aprovimi i një projekti të PPP-së. Këtu edhe është bërë propozimi për një ndarje në mes projekteve madhore, e që duhet të jenë përgjegjësi e Komitetit për Partneritete Publike Private (KPPP), me kufizimin që kjo e drejtë për negociim të jetë vetëm për projekte të cilat e arrijnë maksimalisht shumën 3% të buxhetit të një komune, duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë e madhësisë së komunave respektivisht buxhetit të tyre.

Me qëllim ngritjen e bashkëpunimit në mes të komunave dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal ka ngritur një trupë kordinuese në kuadër të cilit synohet të krijohen kushtet dhe të përkrahen komunitat me projekte konkrete zhvillimore për një zhvillim të qëndrueshëm lokal.

Kolegjiumi për Prokurim: duke pasur parasysh rëndësinë e Prokurimit Publik në komuna në avancimin e proceseve të prokurimit në mënyrë që ata të jenë sa më produktiv dhe efikas në kryerjen e punëve janë ndërmarrtë një varg aktiviteteve përmes informimit për procedurat e nevojshme, aktivitetet kur mund të përdoren, avantazhet si dhe praktikat e mira i cili do të ndikojë në rritjen e transparencës dhe konkurrencës në procesin e prokurimit, kursimin e parave publike, dhe rritjen e cilësisë së projekteve të

financuara me para publike përmes monitorimit dhe përmirësimit të shpenzimeve publike. Një avantazh aktual paraqitet mundësia e vendosjes së komunikimit përmes këtij Kolegjiumi në mes të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës (KRPP) dhe Komunave, në diskutimin e tematikave të ndryshme duke rregulluar strukturën dhe përmbajtjen e kategorive dhe artikujve që janë objekt i procedurave të prokurimit publik nevojave përmes ofrimit të trajnimeve, monitorimit dhe udhëzimeve në përmirësimin e prokurimit publik, në mënyrë që ata të jenë sa më produktiv dhe efikas në kryerjen e punëve. Disa tema të rëndësishme rreth prokurimit në interes të Kolegjiumi për prokurim publik u vlerësuan: “Kontrata Publike Kornizë me Çmim të Peshuar”; “Procedurat Qendrore të Prokurimit Publik”; “Hapat e Procedurës së Kufizuar”; “Platforma e Prokurimit Elektronik”. sa i përket informimit për procedurat e nevojshme, me qëllim që të sigurojë në mënyrën më efikase, transparente të shfrytëzimit të fondeve publike.

Kolegjiumi për Arsim: ka nisur shqyrtimin e Planit Strategjik në bashkëpunim me GIZ-CDBE me objektiv qendror përmirësimin e cilësisë së arsimit, përmes ndërtimit efektiv të kapaciteteve për menaxhimin e arsimit në Komuna në funksion të avancimit të procesit mësimor në Kosovë. Përmes partneritetit me CARITAS (Sëiss), Kolegjiumi është angazhuar në ofrimin e mundësive për investime në shkolla të ndryshme (rrjetin shkollor) në aspektin e edukimit, por edhe atë të përmirësimit të infrastrukturës në pajisje dhe trajnime për arsimin parashkollor. Qëllim specifik është vendosja e standardeve parashkollore të cilësisë së lartë duke përforcuar arsimin, shkencën dhe ekonominë në zgjerimin e rrjetit dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në arsimin parashkollor. Në bashkëpunim të projektit të financuar nga GIZ, janë shqyrtuar mundësitë lidhur me procesin e edukimit të rregullt të fëmijëve të riatdhesuar, ku u është konsideruar si shumë e rëndësishme krijimi i mundësive për shkollim të personave të riatdhesuar. Në përkrahje të Ministrisë së Arsimit (MASHT) është diskutuar Programi Nacional për Rininë, me mundësitë që të gjithë të rinjtë të cilët janë pjesë e sistemit të edukimit në Kosovë, të kenë qasje të barabartë në aktiviteteve jashtë kurrikulare që të ndikojë direkt në zhvillimin dhe zotësinë e tyre, e të cilat janë në shërbim, mbështetje dhe në mundësinë e kanalizimit të dijes dhe talentit të të rinjve kosovarë.

Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa: është angazhuar në diskutimin Librit të Proceseve për Menaxhimin e Financave Publike Komunale, si një udhërrëfyes për zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus analizën dhe menaxhimin e rreziqeve. Libri nxjerr në pah nëse ka ose jo dobësi lidhur me përcaktimin e procesit, do të japë një pamje të përgjithshme të ndërlidhjeve ndërmjet proceseve si dhe mundësitë për përmirësim të operacioneve të organizatave buxhetore. Kolegjiumi konsideron se Libri i Proceseve shërben si model në kryerjen e procesit të punës, identifikimin dhe përgjegjësit për kryerjen e një aktiviteti, shoqëruar me një pasqyrë të kontrolleve të brendshme duke siguruar përmbushjen e objektivave të procesit si dhe mundësitë për përmirësim të operacioneve të organizatave buxhetore.

Kolegjiumi për Administratë: në funksion të avancimit të shërbimeve për qytetarët si rezultat i modifikimeve në platformën e re të intranetit në Komuna, përmes vlerësimeve e rekomandimeve ka kaluar projekt Udhëzimi Administrativ për Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë me të vetmin qëllim të rregullojë mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët në qendrat për shërbime të qytetarëve në komunë, funksionimin e këtyre qendrave, përmes komunikimit,

informimit, e këshillimit me qëllim të përmirësimit e vazhdueshëm të shërbimeve cilësore administrative. Me qëllim informimin e Drejtorëve Komunal të Administratës të cilët kanë marrë për herë të parë këtë detyrë është organizuar punëtorja për ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve nga kolegët e tyre në shkëmbimin e njohurive të tyre rreth organizimit të punës, përmes “Raportit të Vlerësimit Organizativ në Përmirësimit e Punës në Administratë, me Rekomandime” i cili do të jetë dokument mbështetës për kolegët e tjerë në punën e përditshme në Administratë. Edhe një herë punëtorja dëshmoi rolin e madh të Kolegjiumeve të AKK-së, ku shkëmbimi i përvojave në mes përfaqësuesve të komunave është element kyç dhe shumë pozitiv për të avancuar funksionimin sa më të mirë të komunave në dobi të qytetarëve.

Kolegjiumi për Transparencë: Në mbështetje financiare të OSBE-së janë organizuar tre takime. Është hartuar Plani i Punës së këtij Kolegjiumi si dhe janë dhënë komentet dhe rekomandimet në Draft Udhëzimin e ri për Transparencë i cili është punuar nga Grupi Punues i MAPL-së e ku anëtarë kanë qenë edhe një përfaqësues i Kolegjiumit dhe një anëtar nga zyra e AKK-së. Vlen të ceket se draftimi i këtij Udhëzimi ka ardhur si kërkesë e Kolegjiumit për Transparencë në nëntor të vitit të kaluar. Me UA për Transparencë do të lehtësohet puna e komunave në transparencën komunale dhe në varësi të tij Komunitat do të përpilojnë Rregulloret e reja komunale për Transparencë në pjesën e dytë të këtij viti. Poashtu ky Kolegjium ka dhënë komentet edhe në Projektligjin për qasje në dokumente publike dhe Projekt-Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.

6. NDËRTIMI I KAPACITETEVE – NJËSIA E TRAJNIMIT

Bazuar në pikën 4.4 të Strategjisë 2016-2020 së AKK-së dhe interesin e lartë të shprehur nga komunitat për zhvillim të kapaciteteve, me theks të veçantë për zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar politik, në janar të këtij viti AKK ka formuar Njesisë e Trajnimit. Njësia e Trajnimit ka hartuar Strategjinë e Veprimit për vitin 2018-2021 dhe planin inicial të aktiviteteve të saj. Për me tepër, në bashkëpunim dhe në konsultim të ngushtë me anëtarët e Kolegjiumeve të AKK-së janë identifikuar shtatë module potenciale për trajnime.

Strategjia e veprimit të Njesisë e Trajnimit ka marrë mbështetjen e Bordit të ri të AKK-së i cili miratoi atë në takimin e parë. Dokumenti u diskutua dhe u mbështet edhe nga pjesëmarrësit e takimit tradicional të AKK-së, “Friends of the Association”.

Zyrtarët e Njesisë së Trajnimit kanë zhvilluar takime informuese me përfaqësues të disa organizatave që kanë përvojë disavjeçare në ofrimin e trajnimeve për fusha të ndryshme si Oda e Avokatëve të Kosovës, projekti DEMOS, NALAS si dhe ka konsultuar gjithashtu ekspertë të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për të mësuar më shumë mbi procedurat që AKK-ja duhet të ndjek për të certifikuar programin e trajnimeve, siç parashihet në strategji.

Përgjatë vitit 2018, AKK-ja ka kërkuar intensivisht mbështetje financiare për zbatimin e tërësishëm të Strategjisë së Veprimit të Njesisë së Trajnimit. Në kuadër të takimeve me donatorë potencialë, mbështetje e tillë është kërkuar nga BMZ, GiZ, SIDA, OSBE, Ministria e Jashtme e Norvegjisë dhe projekti DEMOS.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve komunale, AKK-ja ka mbajtur trajnimet e gjithë anëtarëve të Kuvendeve të Komunave. Trajnimet janë organizuar në 5 regjionet me nga 9 module. Në trajnimet për anëtar të KK-ve kanë marrë pjesë mbi 850 persona në çdo modul. Këto trajnime janë vlerësuar nga trajnuesit përmes formës së vlerësimit dhe nga kjo formë ka rezultuar që anëtarët e KK-ve kanë kërkuar edhe trajnime të tjera. Janë mbi 80 propozime për trajnime nga anëtarët e KK-ve.

Gjithashtu në fushat dhe prioritete e përcaktuara nga vet kolegjiunet dhe në bashkëpunim me partnerët në vitin 2018 përmes AKK-së janë organizuar trajnime dhe punëtori të ndryshme në të cilat kanë marrë pjesë mbi 1800 pjesëmarrës, Drejtor të emëruar komunal por edhe zyrtarë komunalë të cilët janë përgjegjës për fushat e caktuara të veprimit në komuna. Më shumë aneksi (3)

AKK organizoi edhe punëtoritë njëditore me Kryetarët e Komunave, të zgjedhur për herë të parë me qëllim prezantimin e përgjithshëm të qeverisjes lokale dhe familjarizimit me procedura dhe akte të ndryshme ligjore. Temat e këtyre punëtorive ishin: Ligji për Vetëqeverisjes Lokale, Ligji për Financat Lokale, Prokurimi Publik –përgjegjësitë kryesore të kryetarëve, Ligji për shërbimin civil, Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Demokracia Lokale, Zhvillimi Ekonomik Lokal.

Në vitin 2018 të gjitha Kolegjiunet, përveç që kanë bërë identifikimin e nevojave për trajnime, procesi i ofrimit të tyre ka ndodhur. Një theks i veçantë këtë vit i është dhënë edhe procesit të shkëmbimit të përvojave në mes të drejtorëve komunal. Shkëmbime të cilat kanë mbuluar fushat e administratës, buxhet dhe financa, planifikim hapësinor, shërbime publike, prokurim publik etj. Kjo u ka mundësuar drejtorëve të rinj një integrim më të lehtë në pushtetin lokal dhe qasje më të hapur ndaj sfidave me të cilat do të balafaqohen në të ardhmen, dhe ka qenë shkëmbim përvojave shumë i mirëpritur dhe domethënës.

Në fillim të këtij viti, në funksion të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunale, përmes strukturave të AKK-së janë identifikuar këto tema:

Planifikimi Hapësinor: - Departamenti i Urbanizmit në planifikim hapësinor/zbatimi dhe ndërtimi, - GjeoPortali Komunal Sistemi GIS, - Zhvillimi dhe menaxhimi i njohurive në mbështetje të punëve të Departamentit të Urbanizmit, - Mbështetja e komunave në hartimin PZHK-se / HZK, - Krijimi dhe funksionalizimi i zyrave "one stop shop" në komuna (procesin e aplikimit për Lejen e Ndërtimit).

Shërbime Publike: - Menaxhimi i mbeturinave komunale - (databaza), - Modeli i operimit, - Mbledhja dhe transporti i mbeturinave, - Deponimi, dhe stacionet e transferim, - Riciklimi dhe kompostimi, - Planifikimi financiar dhe - Monitorimi i shërbimeve.

Buxhet dhe Financa: - Rregullorja komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba, - Menaxhimi i financave publike – transparenca dhe kontrolli financiar, - Kriteret në përcaktimin e të hyrave vetanake, - Menaxhimi i pasurive në Komuna.

Prokurim Publik: - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, - Udhëzues: çmimi më i ulët me poentim dhe procedura e kufizuar, - Zbatimi i procedurave qendrore të prokurimit publik.

Administratë: - E-Kiosqet (funksionimi i tyre dhe siguria e Informacionit), - Platforma Digjitale për Partecipim Publik (për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarë), - Platforma Open Data - transparencë komunale, - Sistemi i menaxhimit të pritjes në radhë.

Zyrtarët Ligjor- në bashkëpunim me OSBE-në janë mbajtur trajnime për të gjithë zyrtarët ligjor në 5 regjione të Kosovës në temat: • Përdorimi i gjuhës juridike dhe rëndësia e kualitetit të përkthimit të legjislacionit; - Kriteret ndërkombëtare mbi hartimin e legjislacionin; - Parimet e hartimit dhe shqyrtimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore; - Rregullorja N.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; - Procedura e hartimit të akteve juridike; - Publikimi i akteve dhe të drejtat gjuhësore; - Versionet e ndryshme gjuhësore; - Hartimi Ligjor dhe Hierarkia e Akteve Juridike; - Aktet nënligjore; - Efekti juridik i akteve nën-ligjore të Ligjit që është shfuqizuar – përmes shembujve; - Afati për nxjerrjen e akteve juridike.

7. KOMUNIKIMI DHE FUNKSIONIMI

7.1. Komunikimi me Komunitet

Asociacioni i Komuniteteve të Kosovës vazhdoi edhe këtë vit të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunitet. AKK-ja vazhdon të vlerësohet një organizatë transparente dhe e hapur për anëtarët, partnerët dhe publikun e gjerë. Komunikimi jo vetëm me komunitet por edhe me organizata ndërkombëtare ka bërë që AKK ta ngrisë edhe nivelin e besueshmërisë së saj. Në këtë periudhë tek komunitet janë dërguar mbi 90 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj.

Për të përmirësuar transparencën, në uebfaqen e AKK-së janë vendosur në baza të rregullta të gjitha botimet dhe broshurat të cilat janë hartuar nga AKK-ja dhe nga disa partnerë dhe bashkëpunëtorë tanë.

Në funksion të aktiviteteteve tona në këtë segment ka ndikuar edhe në rritjen e përgjegjësisë tona të përbashkëta në fushën e transparencës komunale ku kemi punuar në draft dokumentet si UA për Standardet Minimale të Konsultimeve me Publikun, UA për Transparencë dhe UA për qasje në dokumentet publike duke dhënë rekomandimet nga niveli lokal.

Në anën tjetër, zyrtari për IT mirëmban në baza ditore uebfaqen e asociacionit ndërsa statistikat tregojnë që gjatë vitit 2018 uebfaqja e AKK-së ka pasur 49,738 vizita gjithsej, me një mesatare mujore prej 4,144 vizitash. Po ashtu, marrë parasysh publikimet periodike, AKK-ja përpilon dhe shpërndan Buletinin e vet, të vetmin për pushtetin lokal në baza dymujore, e cila publikohet në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht). Në këtë periudhë vjetore janë përgatitur publikuar dhe shpërndarë gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë përmes produkteve identifikuese. Në këtë drejtim AKK-ja ka faqen e vet 'Facebook', ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja. Gjatë vitit 2018 janë mbi 135 postime në 'facebook' me 2500 deri në 5200 'shikime' për postim.

7.2. Funkcionimi i strukturave të AKK-së

Asociacioni i Komunave të Kosovës edhe në këtë vit ka përmbushur obligimet statutare lidhur me funksionalitetin e strukturave të veta. Janë organizuar disa takime të Këshillit të Kryetarëve, të cilin organ kemi filluar të fuqizojmë edhe më tutje si dhe është mbajtur takimi i Kuvendit të Përgjithshëm, i cili veç shqyrtimit të raporteve vjetore ka bërë edhe zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe Bordit të AKK-së. Në takimin e Kuvendit janë debatuar edhe çështjet e lobimit në interes të Komunave të Republikës së Kosovës. Bordi ka mbajtur takimet e veta poashtu edhe Këshilli i Kryetarëve dhe Kolegjiumet janë konsoliduar dhe kanë funksionuar me struktura të reja.

8. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

Bashkëpunimi i AKK-së me një numër organizatash në pushtetin lokal në Kosovë përcakton dhe inkurajon Asociacionin për një partneritet me këto organizata me të cilat ai koordinon aktivitetet e veta, ngase ndërlidhen punët e përbashkëta me ta. Kjo ndërlidhet edhe me realizimin e pikës pestë (5) të Strategjisë së AKK-së. Bashkëpunimi me partnerët, AKK-së i ka ndihmuar në lobim, avokim, dhe në realizimin e shumë projekteve nga të cilat komunat kanë përfituar në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. Këto partneritete kanë ndikuar përmirësimin e performancës së komunave, ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme, tejkalimin e mangësive në mungesë të dokumentacionit të kërkuar, bashkëpunimit në mes të komunave me organizata të ndryshme etj.

SDC – Si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së jep kontribut thelbësor në mbështetjen financiare për AKK-në si dhe ka rol kyç në aktivitetet dhe buxhetin e AKK-së. Programi i financuar nga SDC-ja i jep më shumë hapësirë veprimi mbulimit të aktiviteteve të AKK-së, varësisht nga koha dhe nevoja për lobim, për dallim nga projektet e organizatave tjera. Programi mbështetës i financave nga SDC është gjithëpërfshirës në aktivitetet e AKK-së dhe i integruar me buxhetin bazë.

Miqtë e AKK-së – Janë mbajtur takime vjetore me partnerët kryesorë të komunave të Kosovës të përfshira në fushën e qeverisjes lokale. Miqtë e AKK-së po funksionon si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve lokale dhe organizatave partnere të tyre. Vlen të theksohet roli kryesor që AKK-ja luan në koordinimin e takimeve dhe aktiviteteve të tyre.

Partneriteti i AKK-së me projekte të ndryshme ndërlidhet në këto aktivitete kryesore:

- Projekt bashkëpunimi me GIZ në fushën e Shërbimeve Publike Komunale si për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Eficiencën e Energjisë në komuna,
- Projekte të përbashkëta në fushën e qeverisjes lokale kemi pasur me: OSBE (Transparenca Komunale; Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor, Kolegjiumi i Administratës, Kolegjiumi për Inspeksion),

- TEAM/USAID (Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa, Kolegjiumi për Prokurim, Kolegjiumi i Udhëheqësve të Personelit),
- UN-HABITAT (Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor),
- Bashkëpunimi me OSBE-në, në fushën e sundimit të ligjit
- Bashkëpunimi me Projektin e Komisionit Evropian “Mbështetje në zbatimin e pakos së tretë të Energjisë, Ne Efiçencën e Energjisë dhe të Rinovueshme” zbatuar nga ‘GFA Consulting Group’.
- Bashkëpunime në projekte të veçanta me DEMOS, EU Commission, Council of Europe etj.

Në arenën ndërkombëtare është organizuar takimi në Kongresin e Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës (Takimi me Presidenten e Kongresit të Këshillit të Evropës znj. Gudrun Mosler-Törnström (Austria, SOC), pastaj takimi për ditët e demokracisë në Bruksel ku shteti i Kosovës është prezantuar nga simbolet e AKK-së. Pastaj takime në Task Forcën për Menaxhim të Mbeturinave të NALAS, Takime me Task Forcën për Decentralizim Fiskal dhe me Përgjigjësit nga NALAS për të Rinjtë dhe Barazi Gjinore.

9. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E AKK-së

9.1. Përmbledhje e shkurtër

Falë angazhimit të strukturave të AKK-së (administratës dhe nivelit politik), dhe me përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë-sidomos SDC-së, AKK ka arritur që të hyjë në një fazë të re e cila reflekton një qëndrueshmëri të konsiderueshme financiare.

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka si synim të vazhdueshëm ndërtimin e një sistemi të qëndrueshmërisë financiare që garanton ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe statusore të saj. Edhe pse AKK-ja që nga themelimi e deri sot është përballur më vështirësi dhe sfida të shumta që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e saj financiare, ajo arriti që të krijoj jo vetëm një trend pozitiv në krijimin e qëndrueshmërisë financiare, por edhe të ndryshonte perceptimin e komunave për AKK-në. Kjo rezultoi në vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale të bazuara në mirëbesim reciprok.

Kjo është dëshmuar edhe nga pjesëmarrja masive e komunave në Asamblenë e Përgjithshme të AKK-së, që u mbajt në muajin Prill 2018 dhe pjesëmarrjes se komunave më shumicë serbe dhe minoriteteve tjera. Përveç kësaj, vlerësimi i punës së AKK-së dhe kënaqshmëria e Komunave anëtare të saj është duke u matur në mënyrë të pavarur nga sondazhet e përgatitura nga organizata gjermane GIZ. Të dhënat nga këto sondazhe janë shumë inkurajuese duke treguar një kënaqshmëri gjithnjë e më të madhe të komunave dhe akterëve të tjerë me punën e AKK-së.

9.2. Të arriturat gjatë vitit 2018

Objekti i paraparë në buxhetin e AKK-së për vitin 2018 ishte 140,000 €. Gjatë vitit 2018 AKK ka arritur të arkëtoj të hyra nga anëtarësia në shumë prej 183,799.81 € nga totali i buxhetit të paraparë për vitin 2018 i cili kap shumën 140,000 euro. Gjatë kësaj kohe është vërejtur një gatishmëri e lartë e Komunave në kryerjen e obligimeve sa i përket pagesës së anëtarësisë. Nga totali i Komunave, anëtare të AKK-së, deri me tani 28 prej tyre, kanë kryer plotësisht pagesën e anëtarësisë, dhe vetëm 4 pjesërisht.

AKK ka vazhduar me aktivitete lobuese që kanë për qëllim nxitjen e Komunave në kryerjen e obligimeve financiare të AKK-së. Ky lobim është bërë përmes mekanizmave të AKK-së, si Kolegji i profesionalëve dhe në veçanti përmes Këshillit të Kryetarëve si një mekanizëm që mbledh të gjithë kryetarët e Komunave. Vlen të theksohet se brenda kësaj periudhe është mbajtur edhe Kuvendi i Përgjithshëm i AKK-se, ku ka pasur një pjesëmarrje masive dhe një rikonfirmim i kënaqshmerisë se këtij organi në raport me shërbimet e ofruara nga AKK.

AKK ka vazhduar që të llojë në Kolegji i profesionalëve e saj për sensibilizimin e Komunave për të kryer pagesën e anëtarësisë ndaj AKK-së dhe për futjen e pagesës së anëtarësisë në planifikimin buxhetor të komunave. Brenda periudhës referuese ka pasur shumë takime të Kolegji i profesionalëve, me theks të veçantë disa punëtorë të Kolegji i profesionalëve brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë shërbyer si një mundësi e mirë për stafin e AKK-së që të llojë për pagesën e anëtarësisë nga Komunitetet si shpërblim për shërbimet e ofruara. Si rezultat i këtij lobimi, shumë komuna tashmë kanë krijuar linjë të veçantë për pagesën e anëtarësisë në AKK, linjë kjo që është vendosur në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”.

9.3. Financimi nga palët e treta

Financimi nga palët e treta nënkupton grantet e marra nga AKK-ja përveç atyre të pranuar nga programi i financuar nga SDC. Në këtë drejtim AKK-ja për vitin 2018 ka paraparë një buxhet në total prej €98,127 nga organizatat e ndryshme financuese, si NALAS, GIZ.

Në periudhën referuese, AKK ka arritur të realizoj një pjesë të granteve të parapara, përkatësisht në këtë periudhë AKK ka nënshkruar kontratë me NALAS, në shumë prej € 57,000, me GIZ në shumë prej € 89,797.50, dhe me CARITAS në shumë prej 31,150 €. Totali i shumës nga kontratat e nënshkruar deri me tani, kap shifren prej 177,947.50 €, Të hyrat aktuale nga grantet, janë 67,561.50 €, pjesa tjetër ka mbetur për t'u transferuar në vitin 2019.

Përveç kësaj, AKK ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me organizatat si UN HABITAT, OSBE dhe OFAP, USAID TEAM me të cilat është paraparë realizimi i aktiviteteve në kuadër të objektivave të përbashkëta me financimin direkt nga ana e këtyre organizatave.

10. RAPORTI I AUDITIMIT



RSM KOSOVO SH.P.K

Str. Perandori Justinian 62
Qyteza Pejton
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

T + 383 38 609 900
F + 383 38 609 901
DL + 383 45 666 888

www.rsmks.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar Raportin Financiar shoqërues të Asociacionit të Komunave të Kosovës ("OJQ"), të cilat përfshijnë pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018, dhe shënime të raportit financiar, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, raporti shoqërues financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe shpenzimet e paguara nga Asociacioni i Komunave Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2018, në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar.

Bazat mbi Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara më tej në seksionin e *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar*, të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga OJQ-ja për sa i përket pajtueshmërisë me *Kodin e Etikës për Kontablistët Profesionalistë (Kodi IESBA)* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontablistët dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazë mbi opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisje për Raportin Financiar

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar dhe për kontrollin e brendshëm siç e përcakton menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar që është i lirë nga anomalitë materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në përgatitjen e raportit financiar, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së OJQ-së për vazhdueshmërinë, shpalosjen, nëse aplikohet, çështjet që lidhen në vazhdueshmërinë dhe duke përdorur këtë si bazë të kontabilitetit për veq nëse menaxhmenti synon të likullojë OJQ-në, të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternative reale tjetër përveç kësaj.

Personat e ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJQ-së.



Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar

Objektivi jonë ka për bazë të marrim siguri të arsyeshme nëse raportet financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të përpilojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme nënkupton një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me ISA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose të grupuara, ato mund të kenë ndikim në vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit në bazën të këtyre raporteve financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale të raportit financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe zbatojmë procedura të auditimit të cilat u përgjigjen këtyre rrezeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë mbi opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se sa nga ajo që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të OJQ-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e OJQ-së për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në raportin financiar, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që OJQ-ja të të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit financiar, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse raporti financiar paraqet transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Kosovë
6 Mars 2019

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

PASQYRA E BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE

	Shënimet	Për vitin e përfunduar 31 Dhjetor	
		2018 (in EUR)	2017 (in EUR)
BURIMET E FONDEVE			
Fondet e donatorëve	3	378,901	207,975
Të hyrat nga pjesëmarrja e komunave	4	183,800	134,871
Të hyrat të tjera		-	434
TOTALI I FONDEVE NE DISPOZICION		562,701	343,280
PËRDORIMI I FONDEVE			
Shpenzimet e pagave	5	171,908	138,639
Zhvillimi i kapaciteteve	6	152,381	34,220
Lobimi / Avokimi	7	62,469	83,316
Komunikimet dhe publikimet	8	32,849	36,524
Shërbimet e zyrës	9	19,062	49,975
Pajisje dhe furnizime të zyrës	10	14,985	14,378
Shpenzime të tjera	11	11,590	26,104
Shpenzime të udhëtimit	12	10,514	11,341
Shpenzimet kontigjente	13	2,997	-
Totali i Shpenzimeve		478,755	394,497
Suficiti / (Deficiti) i fondeve të marra mbi shpenzimet		83,946	(51,217)
Fondet e kthyer tek donatorët		-	(1,409)
Suficiti i fondeve		83,946	(52,626)
Gjendja fillestare e parasë së gatshme dhe në bankë		139,739	192,365
Gjendja e parasë së gatshme dhe në bankë në fund të periudhës	14	223,685	139,739